

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

Per aktivitetin:

“PRODHIM I PRODUKTEVE PLASTIKE”
(GOTA, PJATA, LUGE, PIRUNA, ETJ),
(aktivitet egzistues)

Vendodhja:

Rruga Monum, Fshati Katund i Ri, Njesia Administrative
Kashar, Bashkia Tirane.

Subjekti: "PREVISA" Sh.p.k

Dhjetor 2020

1. HYRJE

1.1. Te pergjithshme

Duke qene se aktiviteti egzistues nuk ka marre dijene per ndryshimet e legjislacionit Mjedisor dhe specifikisht Ligjit nr.10440 dt 14.07.2022 "Per Lejet e Mjedisit "I ndryshuar, dhe per rrjedhoje te tij edhe VKM nr.419 date 25.06.2014 Seksioni II - per Rishikimin e Kushteve te Lejes egzistuese mjedisore **Nr 96 Prot date 01.04.2013 , aktiviteti egzistues po aplikim nga e para per miratim Leje Mjedisi.**

Ky aktivitet zhvillohet ne ambjentet e nje kapanoni industrial miratuar me Leje Ndertimit me nr Vendimi 11, date 20.01.2015 nga Ish Komuna Kashar per kete destinacion.

2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

2.1. Te pergjithshme

Ne industrine e perpunimit te lendeve plastike njihen shume metoda qe perdoren per prodhimin e artikujve plastike. Ne prodhimin e produkteve plastike si enet e kuzhines nje perdorimshe, perdoret metoda e quajtur "Extrudim – Fryrje".

Makinerite, linjat e kesaj industrie jane te shumellojshme, madje me aftesi prodhuese te ndryshme qe fillojne nga disa kg/ore deri ne disa ton/ore.

Ne teknologjine e perpunimit te lendeve plastike me extruder fryrje duhet te kuptojme metoden qe lenda plastike, ne forme kokrrize granul, kalon ne proces shkrirjeje ne temperature te caktuar dhe pastaj shnderrohet ne flete plastike ku me pas kalon ne nje makineri e cila kryen presimin e ketij filmi prej plastike nepermjet nje procesi me ngrohje.

Kompania Previsa shpk eshte certifikuar nga BID (Business Initiative Direction) ne Paris me cmimin Gold Star per cilesi dhe novacion ne fushen e produkteve te konsumit te perdishem. Si rezultat i zgjerimit te metejshem Previsa shpk u vleresua me Platinum Award for Excellence and Business Prestige ne New York te SH.B.A.

2.2. Vendodhja e prones

Prona ne te cilen ushtrohet aktiviteti "**Prodhim i Produkteve Plastike (Gota, Pjata, Luge, Piruna etj)**", ndodhet prane Autostrades Tirane-Durres, km 8, Fshati Katund i Ri, Njesia Administrative Kashar, Bashkia Tirane. Prona ndodhet ne anen e djathte te rruges dytesore Tirane Vore, prane ekspozites se subjektit "Brunes".

Me poshte paraqitet nje pamje satelitore e zones me vendodhjen e prones ne vleresim.



2.3. Lenda e pare dhe perpunimi i saj

Si lende e pare ne kete proces pune perdoret polyethileni. Polyethileni eshte nje polimer qe nga natyra kimike eshte inerte, nuk hyn ne reaksion me gazrat , me kimikate te ndryshme apo acidet e ndryshme. Edhe gjate perpunimit ne procesin teknologjik te fleteve te bujqesise apo tubave per vaditje, materiali qe del mbas procesit te shkrirjes nuk ndot ambientin ne repartin e perpunimit apo ne ambjentet perreth tij. Kjo shpjegohet me faktin se polyethileni gjate perpunimit i nenshtrohet fenomeneve fizike dhe jo atyre kimike.

2.4. Procesi i punes

Ne vija te pergjithshme nje linje me extrudim fryrjeje ka disa pjese qe ne menyre permbljedhese jane :

Grupi i reduktorit

Cilindri dhe shneku

Koka e extruderit

Kulla terheqese me cilindrato perkates

Terheqesi me matesat

Ne teknologjine e perpunimit te lendeve plastike me extruder fryrjeje duhet te kuptojme metoden qe lenda plastike, ne forme kokrrize (granul), kalon ne proces shkrirjeje ne temperature te caktuar dhe pastaj shnderrohet nepermjet fryrjes ne nje film plastic, I cili kalon me pas ne nje makineri e cila kryen presimin e ketij filmi ne nxehtesi dhe I jep forma te ndryshme duke prodhuar keshtu produktin final te kerkuar.

Kapaciteti prodhues eshte me e madhe se 50 ton /vit.

2.5. Produktet perfundimtare

Produktet perfundimtare te ketij aktiviteti jane :

- Gota plastike te llojeve te ndryshme
- Pjata plastike te llojeve te ndryshme
- Kupa plastike te llojeve te ndryshme
- Piruna plastik te llojeve te ndryshme
- Thika plastike te llojeve te ndryshme
- Luge plastike te llojeve te ndryshme
- Ambalazhe ushqimesh prej plastike



2.6. Mbetjet e procesit te punes

Vlen te permendet se gjate prodhimit te produkteve plastike, krijohen mbetje plastike te ndryshme, te cilat jane 100% te riciklueshme, por duke qene se ne kete impiant prodhohen produkte te ambalazheve ushqimore, per efekt higjense nuk riciklohen nga ky impiant por shiten ne impiante te tjera te riciklimit te plastikes.

Brenda ciklit ditor gjenerohen nje sasi e konsiderueshme mbetjesh, kryesisht nga filtri plastic qe perdoret per stampimin e produkteve te kerkuara.

Keto mbetje priten ne copa te pershtatshme per paketim dhe transportimin e tyre dhe transportohen per ne pikat e grumbullimit dhe riciklimit te tyre. Keto mbetje per investitorin konvertohen ne te ardhura te konsiderueshme, factor ky i cili shmanget hedhjen e tyre ne mbetjet e ngurta te pikave te grumbullimit te komunes.

3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT PER MINIMIZIMIN E TYRE

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njerem prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti eshte i ndertuar dhe ndikimi ne mjedis do te jete vetem nga funksionimi i paisjeve dhe linjes teknologjike. Nuk marrin ne konsiderate fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoje te jete i tille dhe pas shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

3.1. Impakti ne mjedis dhe menaxhimi i tij

Ne vijim do te paraqesim nje permbledhje te efekteve negative mbi mjedisin te cilat lidhen me produktet perfundimtare te prodhimit sebashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

Ndikimet e mundshme ne mjedis te lidhura me prodhimin e produkteve plastike do te vleresohen ne tre elementet e mundshem te cilet jane:

- Shkarkimet ne ajer
- Shkarkimet ne ujera
- Mbetjet e ngurta

• Shkarkimet ne ajer

Procesi i prodhimit te produkteve plastike nuk vleresohet te kete ndikim nepermjet shkarkimeve ne ajer. Kjo duke qene se ky proces nuk perfshine procese kimike te trajtimit te lendes se pare ose produktit perfundimtar, por perfshin vetem procese fizike si per shembull, nxehja e materialit, dhenia e formes dhe ftohja e tij nepermjet estruderit. Lenda e pare polyethileni eshte ne forme te granular dhe ne gjendjen e tij ai hidhet ne enen ushqyese te impiantit. Impianti nga aty e merr lenden e pare dhe e kalon ne nje dhome shkrirje ne temperature te larte rreth 120°C, dhome e cila punon nepermjet kaldajes me avull.

Pasi shkrin lenda kalon ne pjesen e makinerise qe kryen petezimin e saj dhe me pas nepermjet fryrjes dhe disa rulonave te cilet e kalojne lenden lart per ftohje dhe per ne makinerine e stampimit. Shkarkimet ne ajer vleresohen vetem ato te lendes djegese te kaldajes si Gas, ose nenprodukte te naftes. Emetimi i ketyre gazeve nuk eshte ne nivele te larta dhe ndotes i mjedisit ne nivele shqetesuese. Makineria punon sipas porosive te klienteve dhe nuk eshte ne pune vazhdimisht pa pushim. Per kete arsye edhe niveli i emetimit te gazit ne atmosphere nuk eshte vazhdimisht pasi eshte i lidhur me procesin e punes.

• Shkarkimet ne ujera

Ujerrat te cilet shkarkohen nga ky lloj aktiviteti, jane ujerrat e zakonshem urban, te cilet gjenerohen nga ambjentet higjieno-sanitare te objektit dhe aktivitetit human. Ambjenti ne te cilin prodhohen produktet plastike nuk ka nevojte per larjen e tij, pasi procesi eshte nje proces i mbyllur dhe nuk ka derdhje te lendeve ne ambientin e punes. Uji qe perdoret per ftohjen e estruderit, qarkullon me system te mbyllur ku kalon ne depoziten e ftohjes se tij per tu riperdorur serish ne procesin e punes.

• Mbetjet e ngurta

Mbetjet e ngurta qe gjenerohen gjate procesit te prodhimit te produktit perfundimtar:

Mbetjet e ngurta qe gjenerohen nga ky aktivitet jane mbetje plastike te cilat mund te krijohen nga prerja e materialit te produktit perfundimtar dhe pergatitja e tij per paketim. Gjithashtu mbetje te ngurta gjenerohen edhe nga ambalazhi i lendes se pare te cilat gjithashtu jane thase plastmasi dhe aktiviteti human gjate orarit te punes si ambalazhe ushqimesh dhe pijesh, veshje te punes te amortizuara, etj.

PRODHIM I PRODUKTEVE PLASTIKE

Mbetjet qe gjenerohen nga procesi i prodhimit te produkteve plastike, jane mbetje te riciklueshme dhe investitori per te mos pasur firo te konsiderueshme dhe humbje ekonomike mund ti grumbulloje ato dhe ti depozitoje prane impianteve te pershtatshme per riciklimin e plastikes. Kjo pasi produktet e prodhuara aty jane kryesisht per produkte ushqimore dhe per te pasur kushte higjene, keto mbetje mund te dergohen per riperdorim dhe riciklim ne nje impiant te pershtatshem per keto lloj mbetjesh dhe prodhime te ndryshme te produkteve plastike te cilat nuk perdoren per ambalazhimin e produkteve ushqimore. Ndikime te tjera ne mjedisin e zones jane te pasqyruara ne tabelen e meposhtme:

4. MASAT PER MINIMIZIMIN E NDIKIMIT NE MJEDIS

Nga vleresimet e mesiperme, shkarkimet e pritshme ne mjedis jane te uleta dhe nuk perbejne problem serioz per mjedisin.

Masat qe duhen konsideruar per te minimizuar ndikimin ne mjedis jane:

- a) Se pari mbetjet plastike te menaxhohen nepermjet riciklimit duke u riperdorur ne makineri per prodhimin e produktit perfundimtar ose ne rast te kundert te lidhen kontrata per menaxhimin e tyre nga subjekte te specializuar per kete qellim.
- b) Zhurmat te miremenaxhohen duke marre masa izoluese dhe punonjesit te perdorin kufje ne rast te shqetesimit te tyre ne lidhje me degjimin.
- c) Ujerat e perdorur nga ambjentet higjeno-sanitare te lidhen me sistemin e kanalizimeve ne rrjet dhe te mos perdoren metoda te tjera te menaxhimit te tyre.

5. REKOMANDIME

1. Mbetjet e ngurta te gjeneruara nga aktiviteti human te grumbullohen transportohen dhe depozitohen ne oraret e caktuara nga Njesia e Qeverisjes Vendore.
2. Mbetjet e ngurta te gjeneruara nga procesi teknologjik te grumbullohen dhe te menaxhohen nepermjet firmave ricikluese te ketyre lloj mbetjesh.
3. Shoqeria te operoje ne perputhje te plote me normat qe jane ne fuqi, dhe te kryej monitorime te vazhdueshme te tregueseve mjedisor te trysnise ne mjedis.
4. Ne respektohen te gjitha rregullat e mbrojtjes kundra zjarrit gjate operimit ne ndertese dhe te zbatohet rregullorja e MKZ e miratuar .
5. Subjekti ne zbatim te kushteve teknike per sigurine duhet te punesoje me kohe te plote nje punonjes per zbatimin e masave kunder zjarrit.
6. Per te minimizuar impaktin ndaj zhurmave dhe dridhjeve, te perdoren mjete mbrojtese per punonjesit.
7. Subjekti te jete ne dijeni te ndryshimeve te kuadrit ligjor edhe per mjedisin.
8. Te kryhen monitorimet rregullisht dhe te dorezohen cdo 6 muaj prane ARM.
9. Te respektohen te gjitha masat e percaktuara ne kete raport te vleresimit te ndikimit ne mjedis.